



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2021:125046
Datë: 12.07.2022
Numri i dokumentit: 03215991

PPP.nr.102/15

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit T... sh.a, me seli në Prishtinë, kundër debitorëve: A.A, M.A dhe E.H, që të tre nga Ferizaj, rr "...", duke vendosur për ankesën për parregullsi të ushtruar nga debitorët, me datë 12.07.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

Pranohet në tërësi si e bazuar ankesa për parregullsi e debitorëve A.A, M.A dhe E. H e ushtruar kundër urdhrit P.nr.252/14, i datës 30.12.2014, i lëshuar nga Përmbartuesi Privat Atip Mustafa nga Mitrovica dhe **SHFAQIZOHET** dhe **LIHET jashtë fuqisë juridike** urdhri P.nr.252/14, i datës 30.12.2014.

A r s y e t i m

Me urdhërin P.nr.252/14, të datës 30.12.2014, Përmbartuesi Privat Atip Mustafa e ka urdhëruar Stacionin e Policisë në Ferizaj që të ndalohen dhe të sekuestrohen veturat Mercedes, me targa ... ngjyrë e zezë, viti i prodhimit 1989, në emër të debitorit A.A dhe N., me targa, viti i prodhimit 1991, në emër të debitorit E.H, të cilat pas sekuestrimit të njoftohet përmbartuesi privat.

Debitorët A.A, M.A dhe E.H, me datë 21.10.2015, tek Përmbartuesi Privat Atip Mustafa në Mitrovicë, kanë dorëzuar ankesën për parregullsi të ushtruar në bazë të nenit 79, të LPP-së, për Gjykatën Themelore në Ferizaj, duke pretenduar se Përmbartuesi Privat Atip Mustafa ka bërë parregullsi gjatë procedurës së përmbartimit, respektivisht pa njoftimin e debitorëve me nga një kopje të urdhërit për përmbartim ka tentuar sekuestrimin e kolateralit të lënë peng nga debitorët.

Gjykata me rastin e shiqimit të shkresave të lëndës konstaton se përmbartuesi privat Atip Mustafa me rastin e nxjerrjes së urdhërit P.nr.252/14, të datës 30.12.2014, nuk i ka zbatuar dispozitat e nenit 47, par 7, të LPP-së.

Gjykata pas shiqimit të shkresave të lëndës si dhe analizimit të pretendimeve të debitorëve në ankesë gjeti se:

Ankesa e debitorëve është e bazuar

Sa i përket pretendimeve të debitorëve në ankesë se këtë urdhër përmbartuesi privat nuk ua ka dërguar fare asnjërit prej debitorëve me qëllim të shfrytëzimit të së drejtës së tyre në ushtrimin e prapësimit apo edhe të ankesës konformë dispozitës së nenit 69, 70, 71 dhe 77 të LPP-së por pa u bërë i formës së prerë dhe i përmbartueshëm konformë dispozitës së nenit 74, të LPP-së, ky urdhër përmbartimor, përmbartuesi privat ka tentuar sekuestrimin e sendeve të luajtshme, gjykata këto pretendime i konsideron të bazuara ngase me rastin e shikimit të të gjitha shkresave të lëndës P.nr.252/14, gjykata ka konstatuar se debitorëve A. dhe E.H përmbartuesi privat Atip Mustafa, pas nxjerrjes së urdhërit për përmbartim të datës 22.08.2014, nuk ua kishte dorëzuar nga një kopje të urdhërit për përmbartim edhe pse konform dispozitave të nenit 47, par 7, të LPP-së kishte për obligim që nga një kopje të këtij urdhëri bashkë me provat e propozuara nga kreditori t'ua dorëzoj debitorëve të cekur më lart dhe në mungesë të fletëdorëzimit të urdhërit për përmbartim për debitorët A.A dhe E.H, përmbartuesi privat siq shihet e ka nxjerrë urdhërin me numër P.nr.252/14, të datës 30.12.2014, me të cilin e kishte urdhëruar policinë në Stacionin në Ferizaj, që veturat Mercedes, me targa ..., ngjyrë e zezë, viti i prodhimit 1989, në emër të debitorit A.A dhe N., me targa ..., viti i prodhimit 1991, në emër të debitorit E.H, të sekuestrohen dhe të dorëzohen tek përmbartuesi privat. Për më tepër në dispoziten e nenit 47, par 7, të LPP-së, është përcaktuar shprehimisht se: "Aktvendimi për përmbartimin apo urdhëri për përmbartim për sendet e luajtshme i dorëzohet debitorit me rastin e kryerjes së veprimit të parë përmbartimorë. Po qe se sendi i luajtshëm nuk ndodhet në posedimin e debitorit, atëherë vendimi apo urdhëri i dorëzohet edhe personit të cili ndodhet sendi i tillë". Po ashtu nga shkresat e lëndës, respektivisht nga precesverbali i datës 13.10.2015, i hartuar nga përmbartuesi privat Atip Mustafa, nuk konstatohet se i njëjti të ketë vepruar konform nenit 47, par 7, të LPP-së. Andaj, duke i marrë për bazë faktet e cekura më lart, rrjedhë se përmbartuesi privat në rastin konkret gabimisht ka vepruar kur e ka nxjerrë urdhërin P.nr.252/14, të datës 30.12.2014, përkatësisht në radhë të parë para nxjerrjes së urdhërit të cekur më lart ka qenë i detyruar që së pari t'i zbatoj dispozitat e nenit 47, par 7, të LPP-së e pastaj të ndërmarr veprimet tjera të përmbartimit në drejtim të realizimit të kërkesës së kreditorit.

Andaj, gjykata duke u bazuar në nenin 79, të Ligjit për Procedurën Përmbartimore konstatohet se ankesa e debitorëve është e bazuar dhe vendosi që ta pranoj ankesën si të bazuar ndërsa urdhërin P.nr.252/14, të datës 30.12.2014 e shfuqizoj dhe vendosi që i njëjti të mbetet jashtë fuqisë juridike.

Nga të cekurat më lart dhe bazuar në nenin 5, par 5 dhe 79, par 1, 2 dhe 3, të LPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

PPP.nr.102/15, më datë 12.07.2022

GJYQTARI
Faton Ajvazi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.